



Datë: 14.07.2025

Numër Protokolli: 5874/2025

A.nr.1021/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1021/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja R.Z, kundër organit të punësimit: Komunës së Drenasit, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin ,6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin ,1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpalljet jo kompetentë* për të vendosur sipas ankesës numër A.nr.1021/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja R.Z.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile R.Z (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 29.05.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në ankesë të datës 15.05.2025, të Kryetarit të Komunës së Drenasit, lidhur me mos kompensimin për funksionin shtesë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuese, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës del së ankuesja sipas Aktit të Emërimit më numër protokolli 01-112-6116, të datës 04.02.2019, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Zyrës për Informim* në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Drenasit.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton se më Vendimin Nr. 02-020-49438 të datës 29.09.202,2 të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Drenasit, është formuar Komisioni Komunal i Aksionarëve NPL Stacioni i Autobusëve SH.A-Gllogoc, në përbërje: Ekzekutivi i Komunës një anëtar: 1.R.Z, Kuvendi i Komunës dy anëtarë: 2.A.S dhe 3. M.B, ndërsa, më datë 29.02.2024, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit ka nxjerr Vendim 02Nr.400/01-9938, më të cilin ka përcaktuar kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Aksionar për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve SH.A”.

Ankuesja më datë 06.02.2025, përmes emailit ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Drenasit, përmes të cilës ka kërkuar që bazuar në Rregullore (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë dhe qarkores për zbatimin e kësaj rregulloreje, të bëjë kompensimin e funksionit shtesë si Kryesuese e Komisionit Komunal të Aksionarëve, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve SH.A” Glllogovc, mirëpo në bazë të provave të lëndës, kërkesa e ankuses nuk është shqyrtuar.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk qëndrojnë fare konstatimet e dhëna nga Kryetari i Komunës së Drenasit në përgjigjen në kërkesë të datës 15.05.2025, ngase puna ime në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publikë Lokale “Stacioni i Autobusëve”, përmban funksion shtesë, në këtë komision kërkohet ekspertize dhe po ashtu ky komision është vendimmarrës, po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet se nuk plotëson kushtet ligjore të përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, sepse në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për kompensim. Kërkon që të aprovohet ankesa të obligohet Komuna e Drenasit të bëjë kompensim në vlerën 30% të pagës për çdo muaj që ka shërbyer në komision, në emër të funksionit shtesë.

Nisur nga akti mbi të cilin ankuesja bazon të drejtën e saj në kompensim për funksione shtesë, Kolegji konstaton se ndërmarrjet publike komunale nuk kanë statusin e organeve publike dhe se çdo funksion i ushtruar në ndërlidhje me këto ndërmarrje është jashtë juridiksionit të shërbimit civil dhe mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka kompetencë të trajtoj konteste administrative që kanë të bëjmë me ndërmarrjet publike, kështu që, duke qenë se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, juridiksion ky i përcaktuar me nenin 102 të Kushtetues së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton se KPSHCK-ja nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuses së datë 29.05.2025.

Lidhur më të drejtën e ankuses në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore sipas nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, ku shprehimisht parashihet se: Neni 78, paragrafi 1” 1. I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1021/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses R.Z;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.